

Bashkim Selmani, PhD¹
Mevledin Mustafi, PhD²

UDC:
343.9.02:327.88

**NDËRLIDHJET E KRIMINALITETIT TË ORGANIUAR DHE
PASOJAT E TERRORIZMIT NDËRKOMBËTAR NË
SHOQËRINË BASHKËKOHORE - PASOJAT DHE SFIDAT**

**ИНТЕРКОНЕКЦИИТЕ НА ОРГАНИЗИРАНИОТ КРИМИНАЛ
И ПОСЛЕДИЦИТЕ ОД МЕЃУНАРОДНИОТ ТЕРОРИЗАМ ВО
СОВРЕМЕНОТО ОПШТЕСТВО – ПОСЛЕДИЦИ И
ПРЕДИЗВИЦИ**

**INTERCONNECTIONS OF ORGANIZED CRIME AND
CONSEQUENCES OF INTERNATIONAL TERRORISM IN
CONTEMPORARY SOCIETY - CONSEQUENCES AND
CHALLENGES**

Abstract

Time we are going through is filled full of stress and various emotions of general social insecurity, therefore it is understood the daily media rhetoric, that each sentence and news begin and end with the phrase “organized crime, serious crime, criminal, thief, terror, terrorist acts, terrorism etc. This so known and daily phenomenon in obedience also is so unknown to man. Therefore, as a starting point we thought of presenting this commentary necessary, in synopsis form of this

¹ Associate professor in the Faculty of Law at the University of Tetovo (UT) – Tetovo, 2016. Profesor inordinar në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tetovë (UT)-Tetovë, 2016.

² University lecturer and expert in the Ministry of interior of Republic of Macedonia, in the field of organized crime and head of sector in this department. Ligjërues universitar dhe ekspert në Ministrinë e punëve të brendshme të R. Maqedonisë, në lëmin e luftimit të krimit të organizuar si dhe udhëheqës sektorial në këtë dikaster.

scientific work, that elaborates full context of the subject "Organized crime and terrorism". Known and unknown results in society, because in different ways and forms, crime has always accompanied human life, because crime has always been present in human life and it has a nearly his age life. Now is felt and rumored too much because of forms and ways of performing, it is presented always through innovations and unknowns.

Considering the risk of this phenomenon, this study undertakes to analyze the causes, trends, efforts, forms and methods that organized crime uses. The study is intended to clarify the consequences and risks for the general national and international security, where with its dimensions will sensitize the public and scholars knowledge of this issue, to have more knowledge about this phenomenon, as state bodies, civil societies also and the victims themselves and victimized in general, for rights and fundamental knowledge to be protected from these consequences.

Keywords: Criminality, crime, organized crime, interconnections, terrorism, international terrorism, victims, victimization, state bodies, format, manner of performance, crime always is presented through innovations and unknowns.

Qasje mbi fillimin etiologjik të kriminalitetit

Pas përmbysjes se komunizmit, në mbarë Lindjen dhe përfundimin e luftës së ftohtë, shumë shtete vunë re një rritje të shpejtë dhe të paprecedent të krimit të organizuar në vendet e tyre. Kjo gjë vihet re dhe në Maqedoni. Krimi i organizuar tani përbën një sfidë për qeveritë demokratike në të gjithë botën. Ai tashmë përbën një kërcënim imediat dhe direkt për sigurimin kombëtare dhe ndërkombëtare. Bota bashkëkohore po përballlet me epokën e ashtuquajtur epoka e krimit të organizuar dhe terrorizmit ndërkombëtar. Kërkimet kriminologjike dhe terroriste paraqesin një komponentë dhe faktor të fuqishëm të studimit dhe të njohjes së shkaqeve të krimit të organizuar dhe të luftimit të tij. Shtimi i hovshëm i krimit të organizuar, përhapja e disa formave të rrezikshme të sjelljeve kriminale, terrorizmit, terrorizmit politik kriminal, narkomania, shkelja e të drejtave të njeriut, korrupsioni, mashtrimi e kanë aktualizuar edhe më tepër nevojën për thellimin e studimeve dhe njohurive të tilla për të penguar, parandaluar dhe prevenuar në kohën e duhur.³

³ Prof. dr. Bashkim SELMANI, Doc. dr. Mevledin MUSTAFI Grupimet e reja kriminale dhe organizatat e mëdha terroriste kanë ngjashmëri me strukturën e korporatave të biznesit.

1. Krimi i organizuar dhe objekti i saj

Shprehja “krimi i organizuar” po njih një përdorim gjithnjë e me te shpeshte ne fjalorin e përditshëm, jo vetëm te specialisteve te drejtësisë, të kriminologëve dhe te hartuesve të politikave, por edhe në radhët e medias dhe të publikut të gjerë. Megjithëse janë bërë shumë takime ndërkombëtare për këtë lëmi shqetësuese, por akoma nuk ka një definicion përfundimtar për krimin e organizuar, për të cilin të kenë rënë dakord të gjithë. Agjencitë amerikane të zbatimit të ligjit, pranojnë si përkufizim të krimin të organizuar “një aktivitet kriminal të dënueshëm, të vazhdueshëm e vetëveprues, duke pasur një strukturë të organizuar, të ushqyer nga frika dhe korrupsioni dhe të motivuar nga etja për fitim. Në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimin të organizuar, në vitin 2000 jepet ky përkufizim për grupin e krimin të organizuar: “Një grup i strukturuar prej tre ose më shumë personash, që ka ekzistuar për një periudhë kohe dhe vepron në bashkëpunim, me qëllim kryerjen e një ose më shumë krimeve ose veprave penale serioze, në mënyrë që të përfitojnë, direkt ose indirekt, një përfitim financiar ose përfitim tjetër material”. Pavarësisht nga përkufizimet e ndryshme, në parim pranohet se krimi i organizuar ka disa karakteristika thelbësore.⁴

2. Ç’ është krimi i organizuar

Krimi i organizuar është krimi që realizohet me më shumë se një person, me periudhë të gjatë ose me periudhë të papërcaktuar, i cili përdor infrastrukturën profesionale ose infrastrukturën ligjore që i përngjan biznesit, ose përdorimit të mjeteve të detyrimit apo të kërcënimit, të influencës politike apo ekonomike. Është përfitim i jashtëligjshëm sipas një plani të qartë të organizuar krimesh. Prandaj, organizatat e krimin të organizuar, për shkak se kthehen në qendra të fuqishme ekonomike dhe politike të jashtëligjshme, përbëjnë një kërcënim dhe një problem shumë të madh në funksionimin e shteteve demokratike. Ky problem që po globalizohet, me gjithë ekzistencën e ligjeve të brendshme në shtetet demokratike ligjore dhe pranimit nga këto shtete të kuadrit ligjor të marrëveshjeve ndërkombëtare, përsëri vazhdon të jetë në rritje.

Organizatet kriminale në shumicën e rasteve kanë të njëjtën kombësi, megjithëse ndonjëherë krijojnë aleanca me grupe kriminale të vendeve të tjera. Ndërkohë, grupet terroriste, si Al-Kaeda, janë me kombësi të ndryshme. Ato bashkojnë në radhët e tyre persona që nga Lindja e Mesme e deri te Lindja e Lartë. Me përjashtim të ISIS-it, rrjetet nuk janë të lidhur me ndonjë shtet të caktuar.

⁴ ⁴ Bashkim Dr. Selmani “Krimi i organizuar dhe terrorizmi ndërkombëtar”, f. 12-24. Universiteti i parë privat “FON”-Shkup 2009.

3. Është kërcënim nga pikëpamja politike dhe ekonomike ndaj demokracive

Krimi i organizuar, aq sa është kërcënim nga pikëpamja politike dhe ekonomike ndaj demokracive të zhvilluara në vendet perëndimore, po aq, ai përbën një problem serioz edhe për vendet, të cilat punojnë të zhvillohen gjatë periudhës së tranzicionit demokratik. Lidhjet reciproke ekonomike që janë vendosur midis vendeve të ndryshme dhe lëvizja e lirë e njerëzve, e kanë rritur edhe më tepër rrezikun e këtij kërcënimi.

4. Është Kërcënim nga pikëpamja e terrorizmit ndërkombëtar dhe trafikut të lëndëve narkotike

a) *Terrorizmi ndërkombëtar* dhe trafiku i lëndëve narkotike përbëjnë dy kërcënime, të cilat janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe kërcënojnë seriozisht të gjithë njerëzimin dhe vlerat e demokracisë. Të dyja janë bërë pjesë e njëra-tjetrës dhe kërcënimi që kanë krijuar në këto zhvillime, ka fituar një qartësi edhe më të madhe pas përfundimit të “Luftës së Ftohtë”.

b) *Trafikimi i lëndëve narkotike* siguron financimet e nevojshme për blerjen e armatimit të organizatave terroriste dhe radhitet midis elementëve që përdoren në operacionet e pastrimit të parave të zeza.

Koha ka provuar se, siç kanë terroristët nevojë për para, ashtu edhe trafikantët kanë nevojë për organizatat terroriste. Trafikimi i armatimit të narkomanëve me terrorizimin ndërkombëtar tashmë është vërtetuar, se është në marrëdhënie reciproke interesash.

c) *Krimet e organizuara*, të cilat njihen si “*Kriminelët e Rinj*”, përbëjnë zinxhirin e “kriminelëve të mafies së madhe, trafikimit të lëndëve narkotike–terrorizimit”, në formën e një shembulli që nuk është hasur më parë. Me përfundimin e “Luftës së Ftohtë”, mosmarrëveshjet rajonale nuk përfunduan, në të kundërt të saj ato treguan rritje.

Kjo gjendje, duke influencuar drejtpërdrejtë edhe ndaj problemit të narkotizimit ndërkombëtar, rrit përmasat e influencës së kërcënimit dhe zgjeron hapësirat e tij.

5. Krimi i organizuar në procesin e tij historik

Pas “Luftës së Ftohtë”, midis parashikimeve të para në drejtim të marrëdhënieve të krimit të organizuar dhe organizatave terroriste, zuri vend vlerësimi se ai do të vazhdonte të rriste përmasat e lidhjeve që

ekzistonin midis organizatave të krimit të organizuar me organizatat që mbrojnë nacionalizmin etnik, duke përdorur për këtë forcën politike.⁵

Në nenin 5 të raportit që sqaron lidhjet e trafikantëve të lëndëve narkotike ndërkombëtare dhe organizatave terroriste të vitit 1993, përgatitur nga Sektori i Kontrollit të Narkotizimit Ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara, lidhjen e organizatave terroriste me trafikun e narkotikëve e shpjegon në këtë mënyrë:

“Trafikimi i narkotikëve dhe veprimtarive terroriste në botë, me lidhjet që janë krijuar midis karteleve të narkotikëve shikohet edhe më e madhe në rajonet me probleme ekonomike dhe të mbërthyera me probleme etnike”.⁶

Në të njëjtën formë, në vendimin me temë “*Terrorizmi dhe të Drejtat e Njeriut*” që u mor më datën 24 nëntor 1993, në Këshillin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara tërheq vëmendjen për “lidhjet që po fuqizohen midis trafikimit të lëndëve narkotike dhe armatimit me grupet terroriste”. Në nenin 9 të Komunikatës Përfundimtare të Konferencës së Ministrave *Pan-evropianë* të datës 4 shkurt 1994, lidhjet e organizatave të krimit të organizuar dhe organizatave terroriste vlerësohej në këtë mënyrë: “Duke marrë në konsideratë rritjen dhe përhapjen e vazhdueshme të trafikimit të lëndëve narkotike, rritja e pjesëmarrjes në këto veprimtari të organizatave të organizuara që përdorin forcën dhe fuqinë ekonomike përbëjnë një kërcënim seriozë për shoqërinë”.⁷ Edhe në komunikatën politike që u pranua në përfundim të “Mbledhjes Speciale të Kombeve të Bashkuara kundër narkotizimit ndërkombëtar,” që u organizua në Nju Jork më datë 8-10 qershor 1998, solli në rend të ditës lidhjet *terrorizëm-narkotizim*.⁸

⁵ Doc.dr.Mevledin MUSTAFI Prof. dr. Bashkim SELMANI, Në vendet e pazhvilluara ose të botës së tretë do të shfaqeshin lëvizjet e pa kontrolluara dhe qytetet do të rrethoheshin me ndërtime të tëra të pa ligjshme duke krijuar një anarki urbanistike, siç ndodhi me Tiranën deri në vitet 1997. Njësitë e vogla politike do të krijonin forcat e sigurimit të tyre, ndërsa pjesa tjetër do t’i kthenin të gjitha shpresat tek padronët e mëdhenj. Militantët etnikë, forcat e armatosura gri-të zeza, terroristët që drejtonin trafikun e lëndëve narkotike dhe si diktatorët që drejtonin forcat e armatosura do të rrisnin kërcënimet potenciale. Do të formoheshin primitiviteti i politikave në vendet e botës së tretë dhe ushtritë e këtyre vendeve do të thërrmoheshin dhe shpërbëheshin.

⁶ Në nenin 5 të raportit që sqaron lidhjet e trafikantëve të lëndëve narkotike ndërkombëtare dhe organizatave terroriste të vitit 1993, përgatitur nga Sektori i Kontrollit të Narkotizimit Ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara, lidhjen e organizatave terroriste me trafikun e narkotikëve.

⁷ Në nenin 9 të Komunikatës Përfundimtare të Konferencës së Ministrave Panevropiane të datës 4 shkurt 1994, lidhjet e organizatave të krimit të organizuar dhe organizatave terroriste.

⁸ Edhe në komunikatën politike që u pranua në përfundim të “Mbledhjes Speciale të Kombeve të Bashkuara kundër narkotizimit ndërkombëtar” që u organizua në Nju Jork në datat 8-10 qershor 1998, solli në rend të ditës lidhjet terrorizëm-narkotizim.

6. Drejtimi i luftës efektive

Për të drejtuar një luftë efektive ndaj këtyre problemeve, është e nevojshme ngritja e një sistemi konsultimi dhe bashkëpunimi të gjerë, midis vendeve demokratike. Për këto arsye, krimi i organizuar dhe terrorizmi përbëjnë një problem madhor me të cilin ndeshet bota e sotme. Me këto probleme ndeshet ashpër edhe Republika e Maqedonisë. Krimi i organizuar në vendin tonë hodhi shtat me kalimin në sistemin demokratik dhe u perfeksionua me shpejtësi, duke tronditur ndjeshëm stabilitetin politik, ekonomik dhe sigurinë e vendit.⁹ Por, krimi i organizuar në Republikën e Maqedonisë vazhdon të jetë prezent me paratë që i vidhen pasurisë së qytetarëve nëpërmjet tenderëve të të gjitha niveleve që zhvillohen, ku pjesën më të madhe e marrin ministrat përkatës dhe ekipet e tyre të besuar, në shitjen e objekteve të ndryshme shtetërore;

- në deformimin e zgjedhjeve elektorale dhe vjedhjen e votës së qytetarëve;
- në mbulimin e të ardhurave financiare dhe kalimin pa doganë të eksporteve apo importeve të rëndësishme;
- në trafikimin e lëndëve narkotike duke e përdorur Maqedoninë urëkalimi për në Perëndim;
- në kultivimin e lëndëve narkotike brenda Maqedonisë dhe eksportimin e tyre nëpërmjet organizatave kriminale që funksionojnë për këtë qëllim, trafikimi i qenieve njerëzore etj.

Të gjitha këto veprimtari kriminale, nuk mund të kryhen nga një njeri dhe nuk mund të bëhen pa përfitime financiare. Prandaj, ato radhiten te krimi i organizuar. Për ta mbrojtur dhe realizuar këtë krim të organizuar, vazhdimisht direkt ose indirekt pjesë e tij bëhet politika dhe pushtetarët e veshur me imunitet. Këtë e kanë treguar edhe shumë krime të organizuara, të cilat janë zbuluar ose janë aktualisht në hetim. Të gjithë prapa kanë një mburojë politike.

Kur krimi i organizuar rrezikohet nga goditja shtetërore, atëherë ai kalon deri në veprimtari terroriste. Lëndët narkotike që kalojnë nëpërmjet Maqedonisë ose që tregtohen brenda Maqedonisë apo realizohen vetëm nëpërmjet organizatave të krimit të organizuar që përfshin disa

⁹ Bashkim Dr. Selmani “Krimi i organizuar dhe terrorizmi ndërkombëtar”, f.12-24. Universiteti i parë privat “FON”-Shkup 2009.

shtete, si: Turqi, Bullgari, Shqipëri, Itali dhe më tutje. Suksesi për shpartallimin e këtyre korridoreve të lëndëve narkotike apo të armatimit, siç ishte ai me destinacion Mali i Zi-Shqipëri-Maqedoni ka qëndruar, vetëm kur midis shërbimeve sekrete dhe të policive është vendosur një bashkëpunim profesional. Paratë e zeza të përfituara nga organizatat e krimit të organizuar në Maqedoni kryesisht janë hedhur në industrinë e ndërtimeve, nëpërmjet të cilave është realizuar larja e tyre.

Të gjitha këto veprimtari janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen në prezencën e shtetit, i cili është edhe përgjegjësi kryesor ligjor për shpartallimin e krimit apo organizatave të krimit të organizuar. Deri tani shteti nuk e ka justifikuar në kuptimin e gjerë luftën ndaj krimit të organizuar dhe organizatave të krimit të organizuar, përveç rastit të Kumanovës dhe nga kjo mund të konkludojmë se, në Maqedoni përflitet për shifrat marramendëse të vjedhura nga funksionarët e shtetit ose përfitimi duke keqpërdorur pozicionin në strukturat e shtetit në Maqedoni, vijmë në përfundim se mafia për 17 vjet ka qenë aktive në shtet dhe vazhdon të mos hap procedura hetimore për rastet e dyshuara. Megjithatë, mundësitë për ta goditur, çorientuar dhe asgjësuar pjesë-pjesë janë të plota. Kryesorja është pastrimi i politikës nga politikanët e korruptuar dhe që kërkojnë të marrin imunitetin politik, vetëm për të fshehur dhe mbrojtur krimin ekonomik dhe financiar që kanë bërë apo që kanë planëzuar për ta realizuar.

Maqedonia është vend i vogël, nëse ekziston predispozicioni dhe pastërtia politike e politikanëve, krimi i organizuar dhe veprimtaritë terroriste (të heshtura) do të ulëshin në minimum. Por edhe vlerësimi i fundit, Maqedoninë e radhiti në vendet që nuk e ka luftuar në shkallën e duhur krimin e organizuar, andaj prezenca e tij e radhit Republikën e Maqedonisë me siguri shumë të cunguar dhe njëkohësisht, liritë dhe të drejtat e qytetarit paraqiten si të kufizuara.¹⁰

7. Në shtetet e Evropës Lindore dhe të Ballkanit

“Në shtetet e Evropës Lindore dhe të Ballkanit, krerët e krimit të organizuar me kalimin e kohës janë bërë biznesmen të fuqishëm dhe me ndikim, pra edhe partnerë të rëndësishëm të nëpunësve të korruptuar shtetëror”, thekson raporti i Këshilli Informativ Kombëtar amerikan, i cili çdo katër vjet publikon analizën e tij në prag të marrjes së postit të

¹⁰ Bashkim Dr. Selmani “Krimi i organizuar dhe terrorizmi ndërkombëtar” f.12-24. Universiteti i parë privat “FON”-Shkup 2009.

presidentit të ri të Shteteve të Bashkuara në mënyrë që ai ta ketë parasysh vlerësimin global politik, të sigurisë dhe lëvizjeve ekonomike në botë. Ndërkaq, raporti thekson se kjo pjesë e Evropës është e kërcënuar edhe nga veprimi i grupeve radikale islamike “të cilat sipas të gjitha gjasave deri në vitin 2025 do të zhduken nga skena botërore politike dhe sigurisë.” Për më tepër, Al Qaeda, që po fuqizohet, do të jetë rrezik në rritje për Evropën edhe për disa vjet, ndërkohë që do të shkojnë e vijnë nga Ballkani.

8. Çfarë ka qenë ndikimi i terrorizmit strategjik?

Për shkak të veprimeve të mëdha terroriste në vitet e fundit, shërbimet e inteligjencës janë ballafaquar me dozë kritikizmi dhe analizash në rritje. Kjo është fokusuar në këto çështje: Dështimet operacionale, siç mund të jetë dështimi për të parashikuar sulmet terroriste apo mungesa e diturisë dhe aftësisë për t’i parandaluar ato; Mangësitë organizative, siç është mosshpërndarja e të dhënave me shërbime të tjera të inteligjencës dhe departamente qeveritare dhe rezistenca e këtyre organizatave ndaj reformave; dhe Veprimet jodemokratike, duke përfshirë edhe shkeljet e të drejtave të njeriut për jetën private, mungesa e bashkëpunimit me degë të tjera qeveritare siç është parlamenti dhe gjykatat, arrestimet e paligjshme, keqtrajtimi *përfshirë edhe torturën* e të burgosurve, teknikat e paligjshme të marrjes në pyetje, transferimi i të arrestuarve në vende të cilat kanë standarde më të ulëta sa i përket përdorimit të teknikave të shtrëngimit *mënyra si zbatohen këto teknika* dhe akomodimi i politikanëve me politizimin dhe keqpërdorimin e inteligjencës.¹¹

9. Lidhja ndërmjet kriminalitetit dhe korrupsionit

Dihet se lidhja ndërmjet kriminalitetit dhe korrupsionit është rrënjëthellë. Korrupsioni përbën pengesë serioze në rrugën e përparimit ekonomik e të investimeve dhe konkretizohet më dukshëm me nivelin e lartë të papunësisë. Në rrethana të tilla, ngjizja në grupe e krimit të organizuar shndërrohet në një alternativë me leverdi ekonomike

¹¹ Prof. dr. Bashkim SELMANI, Doc.dr.Mevledin MUSTAFI Grupimet e reja kriminale dhe organizatat e mëdha terroriste kanë ngjashmëri me strukturën e korporatave të biznesit. Organizatat kriminale në shumicën e rasteve kanë të njëjtën kombësi, megjithëse ndonjëherë krijojnë aleanca me grupe kriminale të vendeve të tjera. Ndërkohë, grupet terroriste, si Al-Qaeda, janë me kombësi të ndryshme. Ato bashkojnë në radhët e tyre persona që nga Lindja e Mesme e deri të Lindja e Largët. Me përjashtim të ISIS-it, rrjetet nuk janë të lidhur me ndonjë shtet të caktuar.

sidomos për moshat e reja. Grupet terroriste lulëzojnë a më mirë “gjembojnë” më dendur në mjediset ku të rinjtë kanë shanse të pakta për të siguruar të ardhura ose për të bërë karrierë në shoqëri. Deri para 11 shtatorit 2001, krimi i organizuar dhe terrorizmi cilësoheshin shpeshherë si dukuri pa lidhje me njëri-tjetrin. Komitetet e specializuara që merreshin me studimin e sigurisë, strukturat ushtarake dhe të ruajtjes së rendit, i trajtonin subjektet e terrorizmit e të krimit të organizuar vetëm në nivel strategjik, veç e veç, jo në varësi të ndërsjellë.

10. Çfarë ndikimesh kanë këto ndryshime për shërbimet e inteligjencës?

Puna e shërbimeve inteligjente me kalimin e kohës është bërë edhe me ndjeshme, komplekse, e rrezikshme dhe kundërthënëse. Vendimet efektive dhe politikë-bërja në masë të madhe varet në identifikimin e hershëm të problemeve, vlerësimin e shpejtë të pasojave të vendimeve dhe mbikëqyrjen e përkohshme dhe adekuate të implementimit të tyre. Me ndryshimet në mjedisin strategjik është shënuar një rritje në numër dhe llojet e atyre që shfrytëzojnë informatat, si brenda e po ashtu edhe jashtë vendit. Nevojat e tyre ndryshojnë në mënyrë shumë të theksuar. Vetëm nëse vendimet që vinë nga kreu i ekzekutivit dhe hartuesit e politikave janë të mbështetura në informata të duhura, atëherë ato mund të jenë si udhërrëfyese për shërbimet e inteligjencës dhe të jenë kuptimplote për politika të caktuara. Operacionet e shërbimeve të inteligjencës në masë të madhe janë bërë të varura në të dhënat të cilat është vështirë dhe me rrezik të mblidhen. Ruajtja e fshehtësive është shumë e vështirë si për shkaqe teknike e po ashtu edhe për arsye politike. Shërbimet kombëtare të inteligjencës duhet të jenë në gjendje të punojnë me pandanët e tyre në vende të tjera nëse duan që t’i përmbushin misionet e tyre; por prapëseprapë kjo mund të jetë një gjë e ndërlikuar për t’u bërë për shkak të dyshimit reciprok dhe ndryshimeve në praktikat në mes të partnerëve në shërbime. Puna e shërbimeve sekrete në disa vende është vështirësuar mjaft nga kriza e besimit në efikasitetin e tyre dhe zotimet për kontroll demokratik. Problemi është intensifikuar edhe më shumë në ato vende ku opinioni i gjerë publik nuk është i informuar në mënyrë të mjaftueshme për aktivitetet e shërbimeve të inteligjencës dhe metodat për kontrollimin e tyre.

11. Si mund të adresohen këto çështje?

Ekzistojnë katër fusha në të cilat shërbimet e inteligjencës duhet të rregullojnë qasjet e tyre: Mbledhja e informatave dhe përdorimi i tyre; Koordinimi kombëtar dhe bashkëpunimi, ndërmjet shërbimeve të inteligjencës dhe me aktorë të tjerë të sektorit të sigurisë; Këmbimi i informatave me organizatat ndërkombëtare dhe me vende të tjera; dhe Përgjegjësia dhe informimi i opinionit publik. Atentatet e 11 shtatorit 2001 çuan në ndryshimin e këndvështrimit dhe të mënyrës së trajtimit të problemeve të lartpërmendura. Tanimë është plotësisht e qartë se terrorizmi dhe krimi i organizuar janë kërcënime në rend të ditës për sigurinë kombëtare dhe botërore, që duhen këqyrur gjithnjë të pandarë nga shoqi shoqi. Shumica e organizatave kriminale dhe e grupimeve terroriste vijnë nga vendet në tranzicion ose nga vendet në zhvillim.

Trafiku i drogave dhe terrorizmi i kanë forcuar lidhjet mes tyre, duke përdorur bashkërisht “pikat e forta” që ka secili: trafikuesit e drogave “huazojnë” aftësitë e terroristëve, njohuritë ushtarake, pajisjen me armë e municione dhe futjen në brendësi të organizatave klandestine. Nga ana e tyre, terroristët fitojnë nga bashkëpunimi me trafikuesit të ardhura të majme dhe përvojë në shpëlarjen e të hollave që u nevojiten për operacionet që ndërmarrin. Si terroristët, ashtu edhe trafikuesit, përpiqen të shfrytëzojnë dobësitë e organeve të drejtësisë dhe të rregullave bankare. Të dy grupet korruptojnë zyrtarët për të marrë prej tyre pasaporta dhe dokumente doganore të rreme. Lidhjet e terrorizmit me krimin e organizuar e shfaqin veten në trajta nga më të ndryshmet, në përputhje me rrethanat e kushtet përkatëse. Trafikuesit e drogave fitojnë liri të madhe lëvizjeje veçanërisht atëherë kur bashkëpunojnë me ato organizata terroriste, të cilat ushtrojnë kontroll të fuqishëm në zonat ku veprojnë.¹² Programet e drejtuara kundër trafikut të drogave dhe krimin parashikojnë modernizimin e sistemeve, metodave dhe mjeteve të luftës kundër krimin të organizuar dhe njëherazi përgatitjen e stërvitjen e agjentëve për misione antiterroriste.

Pas 11 shtatorit 2001, taktikat e luftës kundër terrorizmit ndryshuan. Thirrja e Xhorxh Bushit e 20 shtatorit 2001 drejtuar bashkësisë ndërkombëtare për një koalicion global kundër terrorizmit ishte e

¹² CIA parashikoi kapjen e qeverisë së Shqipërisë nga mafia. Lajmi sekret ka dalë në formën e një ekstrakti zyrtar nga raporti voluminoz. Në Shqipëri, Maqedoni, Serbi, Mal të Zi dhe Bosnje e Hercegovinë, ekziston rreziku që deri në vitin 2025, krimi i organizuar të marrë kontrollin e plotë në këtë pjesë të kontinentit evropian. Kështu thekson raporti prej 120 faqeve, i hartuar nga ekspertët e të gjitha shërbimeve sekrete amerikane.

barabartë me shpërthimin e një lufte në të cilën shërbimet e fshehta, policia, institucionet financiare, diplomatike dhe njësitë ushtarake duhet të punojnë së bashku dhe të bashkërendojnë çdo veprim që do të ndërmarrin. Një ndryshim tjetër pas 11 shtatorit 2011, ishte kalimi i sulmeve të kriminelëve nga objektivat ushtarake, diplomatike apo qeveritare, në të ashtuquajturit “soft targets”. Këto të fundit janë objektiva me vlera simbolike të fuqishme, që shoqërohen me një numër relativisht të madh viktimash. Bombat që u hodhën kohë më parë në një klub nate në Indonezi, sulmet me predha në hotelet në Xhakartë e në Kazablanka, në një bankë në Stamboll, janë domethënëse për këtë lloj të ri objektivash. Ra në sy edhe një ndryshim i motivimit: vrasja e njerëzve të pafajshëm filloi të përdorej si armë politike. Kështu sulmi në Madrid pati ndikim politik të fuqishëm sepse u krye në prag të zgjedhjeve, çka e ndryshoi tërësisht peizazhin politik. Metoda të tilla u përdorën edhe në Irak: rrëmbimi dhe vrasja e civilëve për të imponuar tërheqjen e personelit civil dhe ushtarak amerikan nga ajo zonë.

Grupimet terroriste përdorin të njëjtët mjete dhe praktika kriminale si ato të krimit të organizuar, për të financuar veprimtaritë e tyre. Për këtë arsye në hetimin e terrorizmit vihen në punë të njëjtat taktika, si për ato të luftimit të krimit të organizuar. Forcimi i drejtësisë është mjeti kryesor për shkatërrimin e organizatave terroriste. Në histori, organizatat terroriste nuk janë zhbërë asnjëherë nga forcat ushtarake. Vetëm ashpërsimi i ligjeve ndërkombëtare dhe zbatimi korrekt i tyre lejojnë goditjen e zonave ku terroristët veprojnë lirshëm.¹³ Përvoja e

¹³ Në raport, vend të veçantë zënë klanet e mafies ruse të cilët së shpejti do më marrin kontrollin ndaj rajonit të Ballkanit Perëndimor. Aktiviteti i krimit të organizuar rus në furnizimin energjetik, do t'i garantoj disa kompanive edhe privilegje në treg, vlerëson ky Këshill, duke parashikuar në të ardhmen konflikte gjithnjë e më të mëdha të interesit rreth burimeve energjetike, ujit dhe ushqimit. Duke pasur parasysh lidhjet e tyre të ngushta me qeveritë dhe bordet e kompanive, kriminelët do të kontrollojnë shtetet, tregun, madje do të formatojnë edhe politikën e jashtme, thekson raporti mbi krimin e organizuar rus. “Në shtetet e Evropës Lindore dhe të Ballkanit, krerët e krimit të organizuar me kalimin e kohës janë bërë biznesmen të fuqishëm dhe me ndikim, pra edhe partnerë të rëndësishëm të nëpunësve të korruptuar shtetëror”, thekson raporti i Këshilli Informativ Kombëtar amerikan, i cili çdo katër vjet publikon analizën e tij në prag të marrjes së postit të presidentit të ri të Shteteve të Bashkuara në mënyrë që ai ta ketë parasysh vlerësimin global politik, të sigurisë dhe lëvizjeve ekonomike në botë. Ndërkaq, raporti thekson se kjo pjesë e Evropës është e kërcënuar edhe nga veprimi i grupeve radikale islamike “të cilat sipas të gjitha gjasave deri në vitin 2025 do të zhduken nga skena botërore politike dhe sigurisë. Për më tepër, Al Qaeda, që po fuqizohet, do të jetë rrezik në rritje për Evropën edhe për disa vjet, ndërkohë që do të shkojnë e vijnë nga Ballkani.

fituar në luftimin e veprimtarive të lidhura me lëndët narkotike, me trafikun e njerëzve, me krimet e me grabitjet, është përhapur edhe në institucionet e ngjashme të shteteve të tjera dhe në agjentët antikrim që veprojnë në terren. Qëllimi është që, kur të hasin individë, të cilët kërcënojnë sigurinë, të mundin t'i ndalin në kohën e duhur. Lidhjet midis krimimit të organizuar dhe terrorizmit për të përmbushur pikësynimet në veprimtaritë e tyre të jashtëligjshme, paraqiten kështu: terroristët përfshihen në veprimtaritë e krimimit të organizuar për të mbajtur veten financiarisht; grupet e krimimit dhe terroristët janë të organizuar në struktura të tipit rrjet dhe terroristët mund të fshihen brenda organizatave kriminale; si grupet e krimimit të organizuar, ashtu edhe grupet terroriste, veprojnë zakonisht në zona me kontroll qeveritar të dobët, me prani të kufizuar të institucioneve të rendit dhe me kufij të hapur; për arritjen e qëllimit, të dyja strukturat përdorin korrupsionin e zyrtarëve; përdorin mjete të ngjashme të komunikimit dhe të teknologjisë moderne; "shpëlarja" e të hollave kryhet nga të dyja strukturat, shpesh me metoda të ngjashme dhe nga të njëjtët operatorë. Shtimi i peshës së veprimtarive të paligjshme në ekonominë botërore siguron resurset financiare për organizatat kriminale ndërkombëtare që të veprojnë me sa më shumë lehtësi. Krahas trafikut të sendeve dhe mallrave me vlerë, e drogave, e qenieve njerëzore, e armëve dhe e pasurive të tjera të rëndësishme natyrore, edhe pirateria ekonomike praktikohet dendur. Me sa thamë më sipër, u sjell fitim të madh grupeve kriminale. Produktet e falsifikuara, si CD-të dhe pajisje të ndryshme elektronike, përfshi falsifikimin e të hollave, përbëjnë një problem të madh që shkakton krimi i organizuar.

Lidhja midis trafikuesve të drogave dhe terrorizmit është e njohur sidomos në zona si Kolumbia FARC dhe Ballkani KLA, por edhe gjetiu: në Afganistan talibanët dhe Al-Kaeda, në Sri Lanka tigrat tamil, në Rusi etj. Gërshetimi i veprimtarive të ligjshme dhe atyre të paligjshme është veçori e veprimeve financiare të këtyre organizatave. Resurset e terroristëve dhe fitimet e organizatave kriminale jo rrallë ngatërrohen qëllimisht me fondet e ligjshme, çka e vështirëson zbulimin e tyre. Kështu, bie fjala, është konstatuar se në bankën New York Case, mjaft fonde, që kanë ardhur nga veprimtari të paligjshme, janë pleksur me ato të ligjshme, me llogari në bankat ruse. Al-Kaeda i përdor fondet e bamirësisë për të kamufluar qarkullimin e fondeve të mëdha të të hollave. Disa nga këto fonde janë të destinuara për veprimtari sociale, por një pjesë e tyre shkojnë për të përkrahur terrorizmin. Është

interesant fakti që sigurimi i dokumenteve të rreme, i kartave të kreditit të falsifikuara dhe i produkteve pirate, bëhet me të njëjtat teknika, si nga terroristët, ashtu edhe nga organizatat kriminale. Grupet kriminale shpesh veprojnë në struktura të tipit rrjet, i cili nuk është veçorizues vetëm për to, por edhe për grupimet terroriste. Strukturat hierarkike të llojit mafioz janë elastike, synojnë të pakësojnë mundësinë e infiltrimit brenda tyre të agjentëve antiterror dhe garantojnë efektivitet të lartë. Krerët e këtyre strukturave nuk zbulohen lehtë.

Ata janë aktorë joshtetërorë që godasin qytetarët dhe simbolet shtetërore. Sikurse e thamë më lart, grupimet kriminale dhe terroristët veprojnë atje ku kontrolli i autoriteteve qendrore është i dobët, ku kufijtë janë të kalueshëm me lehtësi dhe ku strukturat e ligjshme janë të paefektshme. Disa nga këto zona bëhen baza për grupimet terroriste dhe për bashkërendimin e veprimtarive të tyre me organizatat kriminale.¹⁴

Ndër personat që korruptohen nga organizatat terroriste dhe ato kriminale, figurojnë drejtues të strukturave zyrtare, por edhe persona që, megjithëse kanë funksione shtetërore, fshehin të tjera koncepte, prej opozitarësh. Kështu, për shembull, në Rusinë Lindore dhe në Kinë, grupe të fuqishme kriminale, që kanë pasur lidhje me strukturat e vjetra komuniste, kanë ndërmarrë nisma për të mbushur boshllëkun e pushtetit dhe kanë vepruar e veprojnë aktivisht në shkallë globale. Pjesëtarë të strukturave të Sigurimit të Ruisë e të Kinës u kanë dhënë në vazhdimësi ndihmë të madhe. Për të pasur sa më shumë rezultate, si terroristët, ashtu edhe organizatat kriminale ndërkombëtare, shfrytëzojnë teknologjinë e informacionit: përdorin celularë satelitorë, internetin, e-mailin dhe chat-rooms; kodifikime kriptografike dhe stenografike; organizojnë baste në internet. Terroristët e kanë bërë zakon të kërkojnë fonde në sajte për “vepra bamirësie”. Lëvizja e fondeve në shkallë botërore lehtësohet nga teknologjia e informacionit. Për mbartjen e fondeve jepen udhëzime me telefon ose në internet. Pjesëtarët e grupimeve terroriste ndjekin kurse të posaçme për kompjuter dhe software, ndërkohë që specialistë të fushës ua lehtësojnë komunikimin.

Megjithëse grupet kriminale ndërkombëtare zhvillojnë veprimtari për të fituar të holla, ndërsa terroristët ndjekin me përparësi qëllime

¹⁴ Prof. dr. Bashkim SELMANI, Doc.dr.Mevledin MUSTAFI. Mungesa e kontrollit në sistemin bankar dhe lidhjet e bankave me organizatat e krimit të organizuar e kanë bërë edhe më të rëndë këtë çështje. Mundësia e lëvizjes me lehtësi e fondeve të paligjshme në zona të caktuara ndikon në fuqizimin e aftësive operative të grupimeve kriminale dhe terroriste.

politike dhe ideologjike, në thelb përdorin të njëjtat mjete e metoda: bëjnë mashtrime, trafik drogash, qeniesh njerëzore, mallrash të falsifikuara. Shpëlarja e të hollave zë vend ballor në veprimtarinë e krimit të organizuar. Çështja e hetimit të kësaj veprimtarie është e vështirë për shkak të sistemeve bankare të tipit underground, sidomos në Indi, Rusi dhe Kinë. Organizatat mafioze ruse, fjala vjen, kanë sajuar lloj-lloj metodash për shpëlarjen e të hollave. Siç e vumë në dukje, mungesa e rregullave të forta në sistemin bankar përbën një truall të përshtatshëm për veprimtari të kësaj natyre.

12. Kriminaliteti ndërkombëtar pasojat dhe sfidat

Kriminaliteti ndërkombëtar parashikohet të jetë shqetësues edhe në të ardhmen për shkak të diferencave shumë të theksuara ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim; për shkak të ekzistencës së shumë shteteve të dobët, në të cilët kriminaliteti dhe grupet terroriste zhvillohen sepse, në shkallë globale rritet kërkesa për mallra dhe shërbime, të cilat këto grupime mund t'i ofrojnë. Për ilustrim le të përmendim se diferenca kolosale në standardet e jetesës midis qytetarëve në Rusinë Lindore me të ardhura prej rreth 100 dollarë në muaj dhe fqinjëve të tyre të Koresë së Jugut e të Japonisë, me nivel jetese tepër të lartë, përbën një terren tërheqës për veprimtari të paligjshme, si kriminale, ashtu edhe politike.

Organizatat kriminale ndërkombëtare dhe terroristët mund të luftohen dhe të shkatërrohen vetëm me bashkërendimin sa më të mirë të përpjekjeve të të gjithë shteteve, me qëllim që të përcaktohen masa sa më të efektshme parandaluese atje ku ekziston rreziku i implementimit të tyre dhe i goditjes së gjithanshme atje ku veprojnë.

Conclusion

Dear citizens, students and readers get knowledge for your future because this is the path that removes away from the possibility of being a victim of organized crime and international terrorism, you and your children.

In conclusion, it is necessary to note that the efforts and the fight against drug trafficking and international terrorism cannot be implemented completely successfully and continuously with alone efforts that can make countries that are facing these threats. Most of terrorist and criminal organizations don't possess the type of infrastructure that

technological collection methods can easily identify them. Technological advances also help intelligence services themselves for better protection of their secrets and more easily hiding of their activities, such examples include even publicly available encryption methods for communications, widening access to internet, which also enables the exchange of funds and information and commercial growth of available satellite images. Many new threats require greater support in human intelligence for information collect, in particular by individuals who have the necessary of language and cultural knowledge to infiltrate inside terrorist and criminal groups. It is needed national coordination and cooperation in today's security environment, intelligence services have to work more closely with each other as well as with other national security services. The first is a difficult thing, especially for large countries that have multiple intelligence services, though smaller countries have many actors who have functions relating to intelligence, and thus appears a need for better cooperation. In most countries, central intelligence mechanisms consisting of officials at or near the cabinet level are responsible for the coordination of national intelligence estimates. This can be supplemented by measures ensuring that all intelligence services have access to the same base of data and documents, and that frequent contacts take place between agencies working on similar issues.¹⁵

BIBLIOGRAFIA

1. Bashkim Dr.Selmani & Mevledin Dr.Mustafi "Sistemet e sigurisë-Sisteme Security" Shtëpia botuese "FURKAN"-Shkup, 20016
2. Bashkim Dr.Selmani "Krimi i organizuar dhe terrorizmi ndërkombëtar"- Universiteti parë Privat "FON"-Shkup, 2009.
3. Bashkim Dr.Selmani "E drejta e të drejtave të njeriut " Universiteti parë Privat "FON"-Shkup, 2009.
4. Buergenthal. Thomas, Diana Shelton and David Stewart. 2002. International Human Rights in a Nutshell. St. Paul: West Group.
5. Buergenthal. Thomas, Diana Shelton. 1995. Protecting Human Rights in the Americas Cases and Materials. 4th rev. ed., Kehl: Engel.
6. Caney, Simon and Peter Jones eds. 2001. Human Rights and Global Diversity. London: Frank Cass Publishers.

¹⁵ Prof. Bashkim SELMANI, Ph.D., Prof. Mevledin MUSTAFI, Ph.D.

7. Hall, Jerome, Mueller, Gerhard, - Criminal Law and Procedure, Second Ed., Indianapolis 1965
8. Hart, H.L.A., - Punishment and Responsibility, Essays in the Philosophy of Law, Oxford 1968
9. Horvatiq, dreljko, - Izbor kazne u jugoslovenskom kriviçnom pravu i sudskoj praksi, Zagreb 1980
10. Horvatiq, dr Zheljko, Novoselec, dr Petar, - E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, 2., Zagreb 2001
11. Ignatov, A.N.,Krasikov, Jo.A., - Kurs rossijskogo ugolovnogogo prava, Tom 1, Obccajjja çastxx, Moskva 2001
12. Jakobs, Günther, - Studien zum fahrlässigen Erfolgsdelikt, Berlin 1972.
13. Jescheck, Hans-Heinrich, Weigend, Thomas, - Lehrbuch des Strafrechts, Allg. Teil, Fünfte Aufl., Berlin 1996
14. Kambovski, dr Vlado, - Problematika e lëshimit në të drejtën penale Shkup 1982 (cit.- Kambovski) Reforma penalo-juridike para sfidave të shek XXI Shkup 2002 (Kambovski
15. Kaufmann, Arthur,- Das Schuldprinzip, Eine strafrechtlich-rechtsphilosophische Untersuchung, Heidelberg 1961.
16. Kienapfel, dr Diethelm,Höpfel, dr Frank, - Grundriss des österreichischen Strafrechts, Allg. Teil, Wien 2003.